

DREJTORIA E RAJONIT VERIOR SHKODER
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data 26.07.2018

Për: „JUBICA“ Shpk, adrese „Rr. “ Luigj Gurakuqi”, Kuklejt Nr. 108 Shkoder

Procedura e prokurimit: *Procedure e Hapur.*

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-73204-06-04-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Kukës-U.Zapotit, Kukës-Bushtricë (Vasie), K/Rruge Domaj-Draj/Rec (Kufi me Peshkopinë) 71.64 km*” .

Fondi Limit: 130 853 729 leke pa tvsh (njëqind e tridhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e njëzet e nëntë) leke pa tvsh/Buxheti i shtetit.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [Data 11.06.2018] , Numri 23.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomike më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomik “**Alb Shpresa**” sh.p.k & “**Curri**” Shpk, “**Alb Shpresa**” sh.p.k me numer NIPTI **J 72110003 F**, perfaqesues ligjor Z.Mehdi Lala, me adrese: Rr. “ Maliq Muço”, Nd. 6, Hyrja 4 , Ap. 14, Tirane .

- “Curri”Shpk me numer NIPTI J 679027185 S**, përfaqësues ligjor Z. Faik Curri me adresë: Rr. “Kajo Karafili”, Pallati Bimbashi 8/2, Shk.2, Kati II, Ap. 2 Tirane, përfaqësuar ky bashkim nga “ Alb Shpresa” me përfaqësues ligjor Z.Faik Curri, me numer NIPTI J 72110003 F, **përfaqësuar ky bashkim nga “Alb Shpresa”Shpk**, me oferte: **129 600 000** (njëqind e njëzet e nëntë milion e gjashtëqind mijë) **leke pa tvsh.**
2. **“Florida” shpk**, me numer NIPTI **J79602604P**, me përfaqësues ligjore Z.Zeqir Bushgjoka, adresë: Bajram Curri, me oferte: **128 096 852** (njëqind e njëzet e tetë milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) **leke pa tvsh.**
3. **“Jubica” shpk**, me numer NIPTI **K 26529001 I**, përfaqësues ligjor Z.Ndoc Kulla, me adresë: Rr. “ Luigj Gurakuqi”, Kuklejt Nr. 108 Shkoder, me oferte: **113 700 000** (njëqind e trembëdhjetë milion e shtatëqind mijë) **leke pa tvsh.**
4. Bashkimi i operatoreve ekonomik **“Marsi” shpk&”Armemil”&”Arbotec”**.
“Marsi”shpk, me përfaqësues ligjor Z.Ylber Elezi,me numer NIPTI **J 68028214 P**, me adresë: *Lagjia Nr.5, Rruga “Dituria”, Kukes,***”Armemil”Shpk** me përfaqësues ligjor Z. Hasan Seferi, Nr NIPT **J 87730208 C**, me adresë: Lgj. Lapaj, Rr. Nacionale Kukes- Bushtrice km 28, Kukes, **Arbotec”sh.p.k**, përfaqësues ligjor Z. Bujar Bytyçi, NIPT **L 28423201 P**, Lgj.Nr 4, ish markata Kukes, **përfaqësuar ky bashkim nga “Marsi”Shpk**,me oferte: **122 915 830** (njëqind e njëzet e dy milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë) **leke pa tvsh.**
5. Bashkimi i operatoreve ekonomik **“Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” shpk& “Oruçi”Shpk**.
“Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” shpk,me përfaqësues ligjor Z.Agim Kola, me nr NIPT **L 04803001 U**, me adresë: Rr.” Xhorxhi Martini” Nr. 20, Godina 11 – kateshe, Shkalla 2, Kati i 7 Tirane,
“Oruçi”sh.p.k, NIPT **J 88511208 S**, përfaqësues ligjor: **Izet Oruçi**, me adresë: *Lgj.Drinas, Rr. Kukes –Tirane*, **përfaqësuar ky bashkim nga operatori “Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” shpk**, me oferte: **120 991 608** (njëqind e njëzet milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e tetë) **leke pa tvsh.**
6. Person fizik **Z.Adem Pojani (nuk ka dokumenta)**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Adem Pojani

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

Nuk plotëson asnjë nga kriteret e kualifikimit, pasi nuk është ngarkuar asnjë dokument në sistem.

2. “Bashkimi i operatoreve ekonomik“Marsi”Shpk&”Armemil”Shpk&”Arbotec”Shpk

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

1. Preventivi i dorëzuar ne formularin e ofertes është plotësuar gabim.Pas korigjimit te ofertes vlera rezulton nga 122,915,830 lekë e paraqitur dhe e dorezuar nga ju si oferte, behet 127,428,649 lekë ose ndyshimi eshte 3,67 %. Per kete arsye oferta eshte e pa vlefshme.

3. “Bashkimi i operatoreve ekonomik “Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” shpk& “Oruçi”shpk

Përkatesisht per arsyet e meposhtme:

1. Nuk plotesoni kushtet per kualifikim pasi Licenses nr NZ 3124/6 , date 21.09.2009 i shoqerise "ORUCI" sh.p.k, drejtuesit teknik Agim Elezi, Artan Sinaj dhe Vladimir Spahiu nuk janë të siguruar ne listëpagesat e paraqitura;
2. Në kontraten nr.3255 , date 02.07.2018 per furnizimin me asfaltobeton me shoqerine "VEGA"sh.p.k nuk është specifikuar objekti i prokurimit, nuk ka QKL , as dokumenta pronesia, dhe as leje mjedisore ne kundërshtim me kriteret per kualifikim.
3. Ne kontraten e qerese nr.3254, date 02.07.2018 per Autobetonieren me targe AA385 MX, nuk ka te specifikuar objektin e prokurimit.
4. Bilancet kontabel te viteve 2016, 2017 te shoqerise "ORUCI" nuk jane te audituara nga ekspertet kontabel.
5. Akt marrveshja nr.1464 REP, Nr.947/1 Kol, date 02.07.2018 ku shenohet ndarja: “RSM COMPANY” me 80% dhe “ORUCI” me 20% , ndarja e makinerive nuk eshte bere sipas perqindjes se kontrates se bashkpunimit apo akt marrveshjes, konkretisht borepastrueset jane te gjitha te shoqerise "ORUCI" e cila ka marre per siper vetem 20% te punimeve dhe sherbimeve te preventivit .

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**Jubica**” shpk, me numer NIPTI K **26529001 I**, perfaqesues ligjor Z.Ndoc Kulla, me adrese: Rr. “Luigj Gurakuqi”, Kuklej Nr. 108 Shkoder, me oferte: **113 700 000** (njëqind e trembëdhjetë milion e shtatëqind mije) **leke pa tvsh**, **136 440 000** (njëqind e tridhjetë e gjashtë milion e katerqind e dyzet mije) **leke me tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorise Rajonit Verior Shkoder, me adrese; Rr. At Zef Valentini, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar “Florida” Shpk, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **128 096 852** (njëqind e njëzet e tetë milion e nëntëdhjetë e gjashtë mije e tetëqind e pesëdhjetë e dy) **leke pa tvsh**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **16.07.2018**

Ankesa: ka ose jo (Ankesa nuk ka)

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____